



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 10 prill 2013

Nr. i lëndës: 2012-09, 2012-10, 2012-11 dhe 2012-12

A, B, C dhe D

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 dhe 10 prill 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e cila së fundi ka pësuar ndryshime më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesat A, B dhe C janë regjistruar më 12 korrik 2012, ndërsa ankesa D është regjistruar më 17 korrik 2012.
2. Paneli ka miratuar kërkesën e parashtruesit të ankesës që emrat e tyre mos të zbulohen, bazuar në shqetësimet e tyre legjitime për sigurinë e tyre.

3. Paneli i ka komunikuar ankesat A, B, C dhe D bashkërisht, pa paraqykim ndaj mundësisë që më vonë të urdhëroj bashkimin formal të rasteve në pajtim me rregullën 20 të rregullores së vet të punës.
4. Më 4 dhjetor 2012, Paneli ka vendosur të njoftoj shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë për këtë ankesë, duke e ftuar atë të paraqesë vërejtje me shkrim rreth ankesave.
5. Vërejtjet e shefit të Misionit janë pranuar më 11 mars 2013, pasi që ato ishin përkthyer dhe komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
6. Ankuesit nuk ka paraqitur ndonjë informacion tjetër.
7. Më 18 mars 2013, Paneli ka ftuar ShM të parashtroj vërejtje të tjera që ai mund të ketë mbi meritat e rastit. Paneli ka vënë re parashtresat e shumta të ShM të datës 8 prill 2013. Shumë prej këtyre parashtresave kanë të bëjnë me çështjet të cilat Paneli do të duhet të vendos në fazën e meritave të procedurave, ku do t'i trajtoj ato çështje që konsiderohen të rëndësishme për vendim.
8. Përmes kësaj, Paneli urdhëron bashkimin formal të këtyre katër rasteve (A, B, C dhe D), në pajtim me rregullën 20 të rregullores së vet të punës.

II. FAKTET

Faktet e mëposhtme dalin nga informatat që ankuesit i kanë ofruar Panelit.

Ankuesi A:

9. Ankuesi ka kërkuar që emri i tij/saj të mos bëhet publik, për shkak të frikës për sigurinë e tij/saj. Ai/ajo do të referohet si "A".
10. Më 28 qershor 2012, ankuesi, i cili punon si taksist, po e dërgonte me veturë një udhëtar për Gazimestan, aty ku udhëtari dëshironte të merrte pjesë në ngjarjen përkujtimore të Vidovdanit. Duke u kthyer nga rruga kryesore drejt Gazimestanit, A-ja ishte ndaluar nga Policia e Kosovës (PK), ku fillimisht nuk i dha leje të vazhdoj drejt Gazimestanit. Pas bisedave në mes udhëtarit dhe PK-së, ankuesi ishte lejuar të vazhdoj udhëtimin e tij.
11. Menjëherë pas kësaj, derisa i afrohej Gazimestanit, ankuesi ishte ndaluar nga të të ashtuquajturit Njësia Rajonale për Mbështetje Operative (NjRMO), njësi e specializuar policore *ndër të tjera* përgjegjëse për kontrollin e turmës. Sipas A-së, katër ose pesë zyrtarë të NjRMO-së ishin të pranishëm në atë rast. Ata i bëritnin A-së dhe udhëtarit, duke i fyer ata dhe kontrolluar dokumentet e identifikimit të ankuesit, lejen e veturës dhe regjistrimin e veturës. Pretendohet se zyrtarët e NjRMO-së

e kanë pyetur A se prej cilës republikë po vinte ai. Gjithashtu pretendohet se ata e kanë fyer nënën e A-së.

12. Pas kontrollimit të dokumenteve të A-së dhe të udhëtarit, zyrtarët e NJRMO-së kontrolluan makinën, por nuk gjetës asgjë me interes. Rrjedhimisht, zyrtarët e NJRMO-së udhëzuan ankuesin "që ta kthej makinën dhe të zhduket". Sipas A-së, zyrtarët policor të EULEX-it ishin të pranishëm gjatë këtyre incidenteve, kishin vëzhguar se çfarë po ndodhte dhe nuk kishin ndërhyrë. Ankuesi nuk ishte në gjendje të ofroj një numër të përafërt të zyrtarëve policor të EULEX-it të pranishëm në vendngjarje.
13. Ankuesi ka deklaruar se në mënyrë që ta kthej makinë ashtu siç ishte udhëzuar nga zyrtarët e NjMRO-së, së pari ai duhej të vazhdonte rrugës drejt Vushtrrisë, në mënyrë që të ketë hapësirë të mjaftueshme për të bërë gjysmërrotullim, pasi anët e rrugës ishin të bllokuara me pengesa. Pas kthimit të makinës dhe vozitjes drejt Prishtinës, A-ja po ndiqej nga një makinë e NjMRO-së, që i ndezi dritat e saj sinjalizuese. Ankuesi konkludoj se zyrtarët e NJRMO-së donin ta tejkalonin, kështu që ai lëvizi makinën e tij në skajin e rrugës. Në këtë pikë, disa zyrtarë të njëjtë të NjMRO-së, të cilët ju kishin afruar më herët A-së, ndaluan makinën e tyre përpara makinës së A-së dhe i kërkuan atij përsëri dokumentet; në të njëjtën kohë zyrtarë të tjerë të NjMRO-së kanë sulmuar udhëtarin.
14. Ankuesi pretendon se më pas tre zyrtarë të NjMRO-së e dërguan A-në mbrapa një makine të policisë, ku ata e goditën atë me shuplaka dhe e shqelmuuan. Sipas ankuesit, zyrtari i katërt i NjMRO-së qëndroj jashtë makinës, qëllimisht për të siguruar se askush nuk e shihte sulmin. Sipas A-së, sulmi kishte zgjatur rreth 10 deri 15 në minuta. Si pasojë, A-ja kishte mavijosje në kokë, shpinë dhe bark. Ankuesi pohon se kur ishte duke u larguar nga makina, një makinë e EULEX-it ka kaluar aty, mirëpo nuk është ndalur.
15. Pas kësaj, A-ja u lejua që të largohej nga vendi i ngjarjes me udhëtarin dhe zyrtarët e NjMRO-së i thanë që të merrnin rrugën drejt Obiliqit. Më tej, thuhet se A-së dhe udhëtarit ju ishte thënë se zyrtarët e NjMRO-së nuk duan të shohin makinën e tyre në afërsi të asaj zone përsëri dhe i kanë udhëzuar ata "të zhduken, sepse në qoftë se shohin makinën përsëri do t'i rrahin [ata] përsëri".
16. Pastaj ankuesi voziti drejt Graçanicës. A-ja në fillim ishte frikësuar të raportonte incidentin në polici. Xhaxhai i ankuesit (mjek) atëherë takoj A-në dhe e bindi atë që të shkojë në polici dhe ta raportonte çështjen, e që A-ja e bëri menjëherë. Në të njëjtën ditë, rreth orës 18:00, A-ja shkoi në një klinikë për të bërë një kontroll mjekësor. Ankuesi i ka ofruar Panelit të dhëna mjekësore që tregojnë praninë e disa mavijosjeve në trupin e tij, të cilat janë në përputhje me raportin e tij të sulmit.

Ankuesit B dhe C

17. Këta ankues kanë kërkuar që emrat e tyre mos të bëhen publik për shkak të frikës për sigurinë e tyre. Ata do të referohen si "B" dhe "C".
18. Të dy ankuesit si B dhe C deklarojnë se ata ishin duke shkuar drejt Gazimestanit për të marrë pjesë në shërbimin përkujtimor, për të shënuar festën serbe të Vidovdanit më 28 qershor 2012. Të dy ankuesit deklarojnë se policia e Kosovës e pranishëm në Gazimestan ju hoqi fanellat me mëngë të shkurta të pranishmëve, të cilët i ekspozonin simbolet serbe.
19. Pretendohet se duke u kthyer prej Gazimestanit, jo shumë larg nga stacioni i autobusëve të Prishtinës, gurë dhe koktej molotovi ishin hedhur nga djem të rinj në autobusët, në të cilët ata po udhëtonin, duke thyer dritaret e atyre autobusëve dhe duke vënë jetët e udhëtarëve në rrezik. Ankuesit pohojnë se dy udhëtarë ishin plagosën gjatë sulmit. Më tej, ankuesi B pretendon se ai/ajo e kishte humbur vetëdijen pas mbërritjes në Graçanicë për shkak të stresit të shkaktuar nga këto incidente. Ankuesi më pas u dërgua në spital për kontroll. Ankuesi ka ofruar një raport mjekësor të trajtimit që ka marrë.
20. Pretendohet se policia e Kosovës ishte duke i shoqëruar autobusët, mirëpo nuk kishte arritur t'i mbrojnë ata.

Ankuesi D

21. Ankesa është regjistruar më 17 korrik 2012. Sekretariati ka marrë informata shtesë nga ankuesi më 31 tetor të vitit 2012.
22. Ankuesi ka kërkuar që emri i tij/saj të mos bëhen publik për shkak të frikës për sigurinë e vet. Ankuesi do të referohet si "D".
23. Më 28 qershor 2012, D-ja shkoi në Gazimestan me një autobus shkolle, i cili po transportonte fëmijë adoleshent të shkollave në ngjarjen përkujtimore të Vidovdanit. D-ja punon si shofer autobusi dhe mekanik. Në atë ditë, ankuesi ishte në detyrë, që ishte në autobusin në cilësinë e mekanikut.
24. Pretendohet se në rrugën drejt Gazimestan, ankuesi nuk kishte parë "ndonjë provokim nga ana e shqiptarëve gjatë rrugës, të cilët po shikonin, mirëpo ai kishte vërejtur provokime nga ana e NjMRO-së". Është pohuar se zyrtarët e NjMRO-së kishin keqtrajtuar udhëtarët kur ata dolën nga autobusët. Zyrtarët e NjMRO-së i kanë kërkuar vozitësve t'i hapnin dyert e përparme të autobusëve në mënyrë që të jetë në gjendje të kontrollojnë udhëtarët kur ata po zbritnin nga autobusët në Gazimestan. Sipas ankuesit, zyrtarët e NjMRO-së "po ju zhvishnin fanellat me mëngë të shkurta me shenja serbe, i hidhnin ato në tokë dhe i fshinin çizmet e tyre me to e i hidhnin ato në plehra". Më tej, është deklaruar se më pastaj njerëzit ishin lejuar të vazhdonin rrugën e tyre me pjesën e sipërme të trupit të tyre lakuriq ose të pambuluar. Sipas D-së,

"policia e EULEX-it po shikonte gjithë këtë dhe nuk kishte reaguar aspak". D më tej shton se në atë kohë ka pasur një prani e madhe të policisë së EULEX-it në Gazimestan.

25. Ankuesi gjithashtu thotë se pas ceremonisë në Gazimestan, derisa po ktheheshin në Graçanicë, ishin hedhur gurë dhe kokteje molotovi në autobusët, në të cilët ata po udhëtonin. Kjo thuhet të ketë ndodhur pranë një vend të quajtur TMK (UQK), në hyrje të Prishtinës, në afërsi të hotelit Victoria. Është pohuar se dy vetura civile kanë mbërritur në vendngjarje dhe janë ndalur përpara autobusit, duke parandaluar atë të udhëtonte më tutje. D-ja ka deklaruar se "kanë qenë pesë djem të rinj rreth moshës 17 - 20 vjeç në vendngjarje, njëri prej tyre hodhi një koktej molotovi në autobus dhe e kishte fytyrën të mbuluar me një shall".
26. E gjithë kjo pretendohet se ishte parë nga tre zyrtarë të policisë së Kosovës, të cilët po qëndronin disa metra larg nga vendi i ngjarjes. Sipas D-së "ata vetëm po qeshnin". Është pohuar se tre djem të rinj në autobus u lënduan gjatë incidentit, i cili zgjati rreth dhjetë minuta.
27. D-ja ka ofruar fotografitë e autobusit, që ishin marrë pas incidentit, ku tregohen dritare të thyera të autobusit, si dhe gurë në dyshtemenë e atij autobusi. Koktej molotovi që thuhet se ishte hedhur në autobus nuk kishte shpërthyer në ato automjete, por në vend të kësaj ajo shpërtheu në asfalt, para tyre. D-ja ka deklaruar se autobusët më në fund kishin arritur të vazhdojë, duke i dërguar personat e lënduar në klinikën më të afërt në Llapnasellë.
28. Pas një pushimi të shkurtër në Llapnasellë, autobusi ka vazhduar drejt Graçanicës. Në vend parkimin në Graçanicë, autobusi i ankuesit ishte ndaluar nga PK-ja në mënyrë që të fotografohej dhe të regjistrohej dëmi i shkaktuar në autobus. D-ja ka deklaruar se një prej zyrtarëve policor erdhi dhe pyeti se pse ankuesi nuk e ka fotografuar incidentin, ku D-ja ju përgjigj se më e rëndësishme ishte që të merrej bombola kundër zjarrit dhe parandalimi i zjarrit, i cili mund të kishte shkaktuar vdekjen e 50 udhëtarëve, shumica e të cilëve ishin fëmijë. D-ja gjithashtu ofroj që të përshkruaj disa nga autorët, ku D-ja ju kishte parë fytyrat. Sipas ankuesit, zyrtari i policisë "vetëm se u kthye, tundi dorën dhe u largua me automjet të policisë". D-ja nuk është në dijeni që ka ndodhur ndonjë hetim lidhur me këtë rast.

LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

29. Pjesët përkatëse të shkëputura të nenit 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVE (më tutje: Veprimi i Përbashkët), thotë si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe

Ilogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

- (a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përdërisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;
...
- (d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;
- (e) kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit gjatë tërë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar;
- (f) kontribuon në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;

Ligji mbi kompetencat

30. Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (nr. 03/L-053, më tutje: Ligji mbi kompetencat) dhe më saktësisht nenet 7 dhe 8 të tij, rregullojnë përfshirjen dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Neni 7 Kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat e lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të ZPSK-së apo në kuadër të zyrave prokuroriale ku ai apo ajo është e caktuar nga kryeprokurori i EULEX-it dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

Neni 8 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

8.1 Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të ZPSK-së sipas ligjit mbi themelimin e ZPSK-së, dhe krimet, përfshirë këtu tentimin dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krime, të paraqitura në të gjitha pikat e paragrafit 3 të nenit 3 të këtij ligji.

III. LIGJ

PRANUESHMËRIA

Vërejtje të përgjithshme

31. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë atë për shqyrtim, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullave dhe procedurave të saj.
32. Ankesat ishin parashtruar Panelit më 12 përkatësisht 17 korrik 2012, pra brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut (28 qershor 2012), siç përcaktohet me rregullën 25, paragrafi 3.
33. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut që i ngarkohen EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i referohet në mënyrë të veçantë çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me drejtësisë, policisë dhe doganat.
34. Paneli konstaton se me ristrukturimin e misionit, ish komponentët e Drejtësisë, Policisë dhe Doganave u zëvendësuan më 15 qershor 2012 nga Divizioni Ekzekutiv dhe Divizionin për Forcim. Prandaj, këto Divizione të sapokrijuara janë themeluar zyrtarisht dhe kanë qenë në funksion deri më datën 28 qershor 2012, në kohën kur këto incidente konkrete kanë ndodhur.
35. Në rastin konkret, ankesat kanë të bëjnë me dy incidente të ndryshme që janë të dyja të lidhura me festimet e Vidovdanit të datës 28 qershor 2012. Ankesat kanë të bëjnë me një numër të të drejtave të mbrojtura, duke përfshirë të drejtën për jetën (p.sh. neni 2 i KEDNj-së; neni 6 KNMDCP), të drejtën për mos t'ju nënshtruar trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (p.sh. neni 3 i KEDNj-së, neni 7 KNMDCP), e drejta e lirisë dhe sigurisë (neni 5 KEDNj-së, neni 9 KNMDCP), e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i KEDNj-së; nenet 17/23 KNMDCP), e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 i KEDNj-së; nenet 18/19 KNMDCP), liria e shprehjes (neni 10 i KEDNj-së; neni 19 KNMDCP), e drejta e lirisë së tubimit dhe organizimit (neni 11 i KEDNj-së; neni 21/22 KNMDCP), e drejta për një ankim efektiv (neni 13 i KEDNj-së; neni 2 KNMDCP), ndalimi i diskriminimit (neni 14 i KEDNj-së; neni 26/27 KNMDCP).

Parashtresat nga palët

36. Në parashtresat e tij, EULEX-i ka deklaruar se të gjitha rastet duhet të shpallen të papranueshme për arsyet e mëposhtme:

Ankuesi A

37. Në lidhje me ankuesin A, EULEX-i ka pohuar se hetimet e kryera nga Divizioni për Forcim i EULEX-i kanë vërtetuar se personeli i Departamentit për Forcim i policisë (DFP) së EULEX-it që ka qenë i pozicionuar për monitorimin e kësaj ngjarje nuk ka qenë i pranishëm apo nuk ka qenë dëshmitar i dy incidenteve të pohuara nga A-ja.

38. EULEX-i më tej ka pohuar se operacioni policor lidhur me festimet e Vidovdanit ishte një operacion i udhëhequr nga PK-ja, dhe se EULEX-i nuk ka miratuar planin operativ që ishte hartuar. DFP i EULEX-i ka mbajtur një takim të shkurtë njoftues me anëtarët e personelit të cilët do të vendoseshin për monitorimin e elementeve kryesore të operacionit të udhëhequr nga PK-ja. Katër grupe nga dy zyrtarë ishin vendosur dhe ju ishte dhënë fleksibilitet për të monitoruar ngjarjet të cilat u zhvilluar. Gjithashtu, zyrtarët e pozicionuar ishin në kontakt të vazhdueshëm në komunikim me radio me EULEX-in.
39. Thuhet se sipas disa rrethanave të kufizuara, zyrtarët e DFP-së së EULEX-it mund të kenë detyrim pozitiv për të ndërhyrë. Megjithatë, sipas EULEX-it, situata të tilla duhet të jenë të kufizuara - në lidhje me aktivitetet e MMK-së së EULEX-it – aty ku kërkohet ndërhyrje e menjëhershme, ku është e nevojshme në funksion të rëndësisë së drejtës së mbrojtur (d.m.th. ato të drejta që mbrohen nga nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut), dhe nëse një ndërhyrje nga ana e institucioneve shtetërore do të konsiderohet të jetë e vonuar dhe e paaftë për t'i mbrojtur të drejtat e rrezikuara, të cilat përndryshe mund të dëmtohen në mënyrë të pakorrigjueshme. Përveç kësaj, ndërhyrja e EULEX-it duhet të jenë e realizueshme dhe proporcionale për sa i përket burimeve në dispozicion të EULEX-it dhe rreziqeve të mundshme që përfshihen aty.
40. Në mënyrë të përmbledhur, EULEX-i ka deklaruar se nuk ka të dhëna për praninë e policëve të EULEX-it gjatë shkeljeve të të drejtave të njeriut të pretenduara nga ankuesi A dhe pohon se ankesa nuk hyn brenda mandatit të Panelit dhe duhet të shpallet e papranueshme.
41. Ankuesi nuk është përgjigjur ndaj vërejtjeve të EULEX-it.

Ankuesit B & C

42. EULEX-i ka pohuar se nga deklaratat e ofruara nga ankuesit B dhe C, ata supozohet se kanë qenë dëshmitarë të shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera nga PK-ja ndaj personave të tjerë, mirëpo as B-ja e as C-ja nuk pretendojnë se ju kanë nënshtruar shkeljeve të pretenduara.
43. Më tej, EULEX-i ka pohuar se sipas rregullës 25 paragrafi 1 i rregullores së punës së Panelit, Paneli mund të shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person që pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. EULEX-i gjithashtu iu referua vendimit të Panelit 2012-07, ku Paneli i referohet kuptimit të fjalës viktimë duke deklaruar se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("Gjykata") ka gjetur në shumë raste se viktimë nënkupton një person që drejtpërdrejt preket nga veprimi apo mosveprimi në fjalë. Në këtë aspekt, EULEX-i ka deklaruar se Paneli gjithashtu ka vënë në dukje se rregullat e veta të punës nuk parashikojnë sjelljen e një *actio popularis*, d.m.th. ata nuk lejojnë që individë të ankohen kundër veprimeve dhe mosveprimet të pretenduara nga ana e

EULEX-it *in abstracto* thjesht sepse ata mendojnë se ata i shkelin të drejtat e njeriut.

44. Më tej, EULEX-i ka theksuar se në lidhje me hedhjen e gurëve dhe koktejeve të molotovit ndaj autobusëve, ankuesit nuk pretendojnë se ka pasur ndonjë prani të EULEX-it, përderisa po kryhej shkelja e supozuar.
45. Prandaj EULEX-i ka pohuar se subjektet e këtyre ankesave nuk hyjnë brenda mandatit të Panelit dhe duhet të shpallen të papranueshme.
46. Ankuesit nuk ju janë përgjigjur vërejtjeve të EULEX-it.

Ankuesi D

47. EULEX-i ka vënë në dukje se sipas ankesës së D-së, përfshirja e EULEX-it në incidentet e përshkruara kufizohet në të qenit i pranishëm, përderisa kishte ndodhur shkelja e supozuar e zhveshjes së këmishave të pjesëmarrësve me shenja serbe. EULEX-i ka pohuar se ankuesi nuk ka deklaruar se ai kishte qenë subjekt i shkeljes së pretenduar. Prandaj, D-ja nuk mund të konsiderohet viktimë e kësaj shkelje, pasi D-ja nuk ishte drejtpërsëdrejti i prekur nga këto akte. EULEX-i ju është referuar dokumenteve të veta të parashtruara në lidhje me ankuesin B dhe C.
48. Më tej, EULEX-i ka pohuar se në lidhje me hedhjen e gurëve dhe koktejeve të molotovit ndaj autobusëve, ankuesi nuk pretendon se ka pasur ndonjë prani të EULEX-it përderisa kryheshin shkeljet e supozuara.
49. Sipas kësaj çfarë u tha më lart, EULEX-i ka pohuar se aplikacioni i paraqitur nga ankuesi D nuk hyn brenda mandatit të Panelit dhe duhet të shpallet i papranueshme.
50. Ankuesi nuk ju është përgjigjur vërejtjeve të EULEX-i.

Vlerësimi i Panelit

51. Para se të bëhet vlerësimi i çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me pranueshmërinë e këtyre ankesave, Paneli do të shqyrtojë nëse ankuesit B, C dhe D kualifikohen si "viktima" për shkak të pranueshmërisë. EULEX-i nuk e konteston statusin viktimë të A-së.

Statusi i viktimës

52. Siç u diskutua më sipër, EULEX-i ka pohuar se B, C apo D nuk kualifikohen si viktima sa i përket nenit 3 të KEDNj-së, pasi ata nuk kanë qenë personalisht objekt i ndonjë lloj trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar.
53. Qëndrimi i marrë nga EULEX-i duket tepër kufizues. Të tre ankuesit ishin të ekspozuar ndaj rasteve të dhunës serioze shkaktuar individëve të tjerë, të cilin ata i njihnin dhe kishte udhëtuar me të. Ata ishin të vetëdijshëm se nuk ka pasur asnjë arsye të valide për abuzimin që ju

ishite bërë këtyre njerëzve, prandaj ata kishte arsye që të frikësoheshin për veten e tyre. Kjo duhet të ketë shkaktuar ankth dhe siç kanë dëshmuar në ankesat e tyre, dëmtime të rënda mendore, të cilat Paneli konsideron të jenë të tillë që të jenë mjaft serioze që të përbëjnë shkelje të nenit 3 të KEDNj-së/nenin 7 KNMDCP.

54. Ky vlerësim *prima facie* e përcjell qasjen e zhvilluar nga Gjykata, e cila thotë se "kur trajtimi poshtëron ose përul një individ, duke treguar një mungesë të respektit, ose duke zvogëluar dinjitetin e tij apo të saj, apo duke i ngjallur ndjenjat e frikës, ankthit, frikës apo inferioritet të afta për ta thyer qëndresën morale dhe fizike të individit, ajo mund të karakterizohet si poshtëruese dhe gjithashtu bien në kuadër të ndalimit të nenit 3" (shih Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 2346/02, aktgjykimi i datës 29 prill 2002 në par. 52). Në këtë drejtim Paneli gjithashtu vë në dukje qasjen që është zhvilluar nga Gjykata se "një kërcënim i sjelljes së ndaluar me nenin 3, nëse ajo është mjaft reale dhe e menjëhershme, mund të bien ndesh me atë dispozitë" (shih Gäfgen kundër Gjermanisë, nr. 22978/05, aktgjykimi i datës 1 qershor 2010 në par. 91). Më tej, natyra publike e çdo trajtimi është relevante me karakterin e tij poshtëruës, ndonëse ajo mund të jetë e mjaftueshme që një person është i poshtëruar para syve të tij ose të saj. (Krahaso Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 5856/72) gjykimi i datës 25 prill 1978 në par. 32).
55. Prandaj, Paneli kundërshton arsyetimin e EULEX-it, se veprimet dhe mosveprimet e pretenduara të përfshira në një ankesë *abstracto* ose *actio popularis* që ju referohen shkeljeve të të drejtave të njeriut nuk lidhen me këto ankesat të caktuara. Ankuesit ishin pjesë e një grupi, të cilët drejtpërdrejtë kanë qenë në shënjestër. Të qenit anëtar i një grupi të tillë dhe të qenit i pranishëm në vendin e incidentit të supozuar, edhe në qoftë se nuk kanë qenë fizikisht të prekur, padyshim vërteton një lidhje mjaft të afërt me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, duke rezultuar në lëndim, përfshirë dëmtim mendor dhe vuajtje emocionale. Kështu, Paneli pranon që rrethanat e rastit vërtetojnë në mënyrë të mjaftueshme që ankuesit përmbushin kushtet e të qenit viktimë të përcaktuara nga Gjykata sikur personat të prekur drejtpërdrejt nga veprimi apo mosveprimi në fjalë (gjithashtu krahaso edhe *lbishi kundër EULEX-it*, 2012-07, 15 janar 2013 në paragrafët 6-8).

Të drejtat e mbrojtura

56. EULEX-i nuk ka arritur të konsideroj dhe ta trajtoj një numër të të drejtave të tjera të mbrojtura, të cilat mbase kanë mundur të jenë shkelur në këtë rast, në veçanti, e drejta e ankuesit për jetën (p.sh., neni 2 KEDNj; Neni 6 KNMDCP), e drejta e tyre për liri dhe siguri (neni 5 KEDNj; neni 9 KNMDCP), e drejta e tyre për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 KEDNj; nenet 17/23 KNMDCP), e drejta e tyre për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 KEDNj; Nenet 18/19 KNMDCP), liria e shprehjes (neni 10 KEDNj; Neni 19 KNMDCP), e drejta e tyre për lirinë e tubimit dhe shoqërimit (neni 11 KEDNj, Neni 21/22 KNMDCP), e drejta për ankim efektiv (neni 13 KEDNj; Neni 2 KNMDCP),

ndalimi i diskriminimit (neni 14 KEDNj, neni 26/27 KNMDCP). Duke pasur parasysh se EULEX-i nuk ka bërë ndonjë parashtrim në lidhje me këto të drejta dhe duke marrë parasysh treguesit *prima facie* që disa ose të gjitha këto të drejta mund të ketë qenë shkelur nga sjellja e kontestuar, Paneli konstaton se ankuesit A, B, C dhe D mund të konsiderohen "viktima" të shkeljeve të këtyre të drejtave për qëllimin e përcaktimit të pranueshmërisë së ankesave të tyre. Paneli mban pozicionin e vet sa i përket asaj nëse disa ose të gjitha këto të drejta në fakt ishin shkelur dhe nëse EULEX-i mund të mbahet përgjegjës për ndonjë shkelje të tillë.

Mandatit ekzekutiv i EULEX-it dhe atributet

57. EULEX-i argumenton se mungesa e pretenduar e zyrtarëve të EULEX-it në vendin ku kanë ndodhur abuzimet e supozuara do të thotë se EULEX-i nuk mund të mbahet përgjegjës për shkeljen e pretenduar. Këto parashtrësia nuk janë vendimtare për të paktën dy arsye.

Mungesa e pranisë së EULEX-it në vendin e ngjarjes

58. Së pari, Paneli merr parasysh parashtrësat e EULEX-it se personeli i tij nuk ka qenë i pranishëm në disa vende që lidhen me këtë rast. Paneli mban pozicionin e vet sa i përket ndërlidhjes, nëse ka ndonjë, së këtij fakti me qëllimin e përcaktimit të meritave të rastit në fjalë.

59. Së dyti, EULEX-i nuk ka arritur të theksoj apo ta adresoj në mënyrë të saktësuar nenin 3 (d) të veprimit të përbashkët të Këshillit, e cila duket të jetë e rëndësishme në përcaktimin që pritet nga Paneli. Kjo dispozitë thekson se EULEX-i do të:

"(d) të sigurojë që rastet e [...] krimeve ndër-etnike, [...] dhe krimeve të tjera serioze të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen, në përputhje me ligjin në fuqi, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjyqtarët ndërkombëtarë së bashku me hetues hetuesit, prokurorët dhe gjykatës të Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe duke përfshirë masat, nëse është e përshtatshme, e krijimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave midis autoriteteve të policisë dhe prokurorisë."

60. E konsideruar në kontekstin e kësaj dispozite dhe duke u bazuar në atë që EULEX-i ka pranuar se zyrtarët e tij në të vërtetë ishte dërguar në ato ngjarje, Paneli është i mendimit se ekzistojnë tregues të mjaftueshme *prima facie* se përfshirja e zyrtarëve të EULEX-it në monitorimin e këtyre ngjarjet hyn në kuadër të ushtrimit të mandatit të Panelit. Megjithatë nëse ShM dëshiron të mos pajtohet me këtë konstatim, Paneli fton ShM të ofroj një përkrahje të hollësishme të rrethanave në të cilat zyrtarët e EULEX-it ishin dërguar për të marrë pjesë në këto ngjarje dhe në çfarë cilësie dhe sipas çfarë mandati ata ishin dërguar.

Mos hetimi

61. Së treti, Paneli vëren parashtresat e EULEX-it në lidhje me hapat e caktuar hetimor të ndërmarra nga EULEX-i dhe/ose autoriteteve kompetente të Kosovës në lidhje me disa nga incidentet që përbëjnë bazën e ankesave. Paneli do të marrë parasysh ndërlidhjen e këtyre në fazën e meritave të procedurës dhe do ta ftoj ShM të ofroj hollësira të mëtejshme në lidhje me shkallën në të cilën këto raste të caktuara të ankuesve ju ishin nënshtruar një hetimi, çfarë ishte bërë prej kujt dhe çfarë ishte vërtetuar nga ky hetim.
62. Paneli konsideron se në bazë të parashtrimeve të palëve, ankesat ngrisin çështje serioze të fakteve dhe ligjit sipas nenit 3 të KEDNj/neni 7 KNMDCP (në lidhje me ankuesit A, B, C dhe D), nenit 2 KEDNj/neni 6 KNMDCP, nenit 5 KEDNj/neni 9 KNMDCP), nenit 8 KEDNj/nenet 17/23 KNMDCP, nenit 9 KEDNj/nenet 18/19 KNMDCP, nenit 10 të KEDNj/neni 19 KNMDCP, nenit 11 KEDNj/neni 21/22 KNMDCP, nenit 13 KEDNj/neni 2 KNMDCP, dhe nenit 14 KEDNj/neni 26/27 KNMDCP, përcaktimi i të cilave kërkon shqyrtimin e meritave të ankesave.
63. Prandaj, Paneli konkludon që këto ankesa qartas nuk janë të pabazuara. Nuk është vërtetuar ndonjë arsye tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

SHPALL TË PRANUESHME, pa i paragjykuar meritat, ankesat në lidhje me shkëljet e pohuara të nenit 2 KEDNj/neni 6 KNMDCP, neni 3 KEDNj/neni 7 KNMDCP, neni 5 KEDNj/neni 9 KNMDCP), neni 8 KEDNj/nenet 17/23 KNDCP, neni 9 KEDNj/nenet 18/19 KNMDCP, neni 10 i KEDNj/neni 19 KNMDCP, neni 11 KEDNj/neni 21/22 KNMDCP, neni 13 KEDNj/neni 2 KNMDCP, dhe neni 14 KEDNj/neni 26/27 KNMDCP;

KONSIDERON se këto raste duhet të trajtohet me shpejtësinë e duhur në mënyrë që Paneli t'i drejtoj palët të paraqesin parashtresa shtesë, nëse ka, në lidhje me meritat e këtyre rasteve brenda afateve të mëposhtme:

1. ShM ka sugjeruar se ai do të paraqes vërejtje të tjera rreth meritave të kësaj çështje, jo më vonë se me datën 19 prill 2013. Kërkesat për dhënien e kohës shtesë do të jepen vetëm nëse paraqiten rrethana të jashtëzakonshme.
2. Ankuesit do të ketë afat deri në 2 maj 2013 për t'u përgjigjur dhe komentuar rreth cilësdo çështje të re të ngritur nga ana e shefit të misionit në vërejtjet e tij, në ka ndonjë.

FTON ShM dhe ankuesit që në mënyrë të saktësuar t'i trajtojnë, në parashtrësat e tyre, nëse ka ndonjë, çështjet e identifikuara në këtë vendimin si të rëndësishme për vendosjen e kësaj çështje dhe të ndonjë çështje tjetër, që palët e konsiderojnë si të rëndësishme për meritat e këtij rasti e që deri në tani nuk është trajtuar në parashtrësat ekzistuese.

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda Mierzewska
Kryesuese